

VENDIM
Nr. 227, datë 7.5.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.5.2015, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Miranda Rira.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Miranda Rira, deputet i zonës zgjedhore, qarku Elbasan, KQZ-ja, në zbatim të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 qershor 2013, ka fituar 2 mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarkun Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatohet se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, pjesëtare e Koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste, për 12 zonat zgjedhore.

Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan, e miratuar nga KQZ-ja, kandidati me numër rendor 2 është znj. Miranda Rira, zëvendësohet po me të njëjtën gjini së cilës i përket nr. rendor 7 (shtatë), znj. Edlira Nuri Çekrezi.

Sipas listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për qarkun Elbasan kandidat, i cili renditet me numër rendor 7 (shtatë), është znj. Edlira Nuri Çekrezi. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se, personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë

nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Miranda Rira është znj. Edlira Nuri Çekrezi, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 7 (shtatë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, qarku Elbasan, znj. Edlira Nuri Çekrezi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.